



UNMIK/REG/2008/18
26 mars 2008

RREGULLORE NR. 2008/18

**PËR THEMELIMIN E BORDIT KOSOVAR MBI STANDARDET E
SIGURISË PUBLIKE DHE ARSIMIN**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh, mes tjerash, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Fundamentale dhe Protokollet e saj dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj,

Duke marrë parasysh nenin 8 të Rregullores së ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/54 e datës 20 dhjetor 2005, mbi kornizën dhe parimet udhëzuese për Shërbimin Policor të Kosovës,

Pas konsultimit me Qeverinë dhe marrjen e pëlqimit të saj,

Me qëllim të vendosjes së standardeve për punësim, trajnim dhe arsim për shërbyesit civil të punësuar në fushat që lidhen me sigurinë publike, mes tjerash, me shërbimin policor, shërbimet korrektuese, shërbimet doganore dhe shërbimet e emergjencës, duke përfshirë edhe shërbimet e zjarrit,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Bordi për standardet e sigurisë publike dhe arsimin

Themelohet Bord kosovar mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimin (më tutje: “Bordi”) si organ profesional i pavarur mbi standardet. Ashtu siç është përcaktuar këtu, Bordi do të përcaktojë standarde minimale profesionale për punësim dhe trajnim të shërbyesve civil, duke përfshirë të gjithë zyrtarët e punësuar në fushat që lidhen me sigurinë publike, mes tjerash, shërbimin policor, shërbimet korrektuese, shërbimin doganor dhe shërbimet e emergjencës, duke përfshirë edhe shërbimet e zjarrit.

Neni 2
Përgjegjësitë e Bordit

2.1 Bordi është përgjegjës për vendosjen e:

a. standardeve minimale profesionale për punësim të shërbyesve civil në fushat që lidhen me sigurinë publike dhe atë:

- (i) moshën;
- (ii) kualifikimin për vozitje dhe historinë e vozitjes;
- (iii) dosjen penale;
- (iv) përdorimin e substancave të kontrolluara;
- (v) arsimin;
- (vi) përvojën profesionale;
- (vii) gjendjen fizike dhe
- (viii) ekzaminimin mjekësor

b. standardeve minimale profesionale për trajnim të shërbyesve civil të punësuar në fushat që lidhen me sigurinë publike dhe atë:

- (i) trajnimin bazik;
- (ii) trajnimin në terren apo pa shpëputje nga puna;
- (iii) zhvillimin e karrierës profesionale;
- (iv) trajnimin e specializuar;
- (v) trajnimin e mbikëqyrur;
- (vi) trajnimin për menaxhim të mesëm dhe
- (vii) trajnimin për menaxhim të lartë.

c. rregullave për heqjen e cilitdo nga standardet minimale të vendosur në pajtim me nënnetet 2.1 (a) dhe 2.1 (b), duke përfshirë edhe heqjet e bazuara në trajnime ekuivalente apo përvojën.

2.2 Bordi certifikon të gjitha kurset e obligueshme për trajnim që do të kërkohen për shërbyesit civil të punësuar në fushat e lidhura me sigurinë publike. Të gjitha kurset e certifikuara do t'i nënshtrohen një rishikimi përmbajtjesor nga Bordi çdo tri (3) vjet.

2.3 Bordi mund të sigurojë një forum për diskutime lidhur me zhvillimin e politikave trajnuese për siguri publike dhe Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë mund t'i bëjë rekomandime mbi politikat trajnuese të sigurisë publike.

2.4 Bordi i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës mbi implementimin e përgjegjësiave të tij dhe mbi të gjitha informacionet tjera relevante financiare, të cilin raport Kuvendi ia dërgon Kryeministrit. Raporti vjetor i Bordit gjithashtu përfshin: (a) vlerësimin mbi gjendjen e trajnimit dhe arsimit në fushën e sigurisë publike në Kosovë; (b) rekomandime për përmirësim dhe (c) çështje të tjera që mund t'i kërkojë Kuvendi i Kosovës. Bordi mund të nxjerrë raporte të veçanta nëse e konsideron të nevojshme se duhet t'i dërgohen Kuvendit të Kosovës, i cili Kuvend raportet e tilla ia dërgon Kryeministrit. Të gjitha raportet e Bordit bëhen publike në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe do të botohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Neni 3

Përbërja e Bordit

3.1 Bordi përbëhet prej katërbëdhjetë (14) anëtarëve si vijon:

- a. Komisioneri i Policisë;
- b. Komisioneri i Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- c. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor;
- d. Drejtori i shërbimeve të emergjencës;
- e. Drejtori i zyrës për siguri publike nga Zyra e Kryeministrit;
- f. Kryeprokurori i Kosovës;
- g. Shefi i Departamentit të arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- h. Kryeshefi ekzekutiv i Qendrës kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim;
- i. Një gjyqtar nga Gjykata Supreme e Kosovës, i emëruar nga kryetari i Gjykatës Supreme për një mandat katër (4) vjeçar pa mundësi të vazhdimit, përveç të emëruarit të parë i cili do të shërbejë për një mandat dy (2) vjeçar pa mundësi të vazhdimit;

- j. Një anëtar nga Dhoma e avokatëve të Kosovës, i emëruar nga Këshilli i saj ekzekutiv për një mandat katër (4) vjeçar pa mundësi të vazhdimit;
- k. Dy (2) anëtarë nga këshillat e sigurisë së komuniteteve komunale (“KSKK”) dhe dy (2) anëtarë nga komitetet lokale për siguri publike (“KLSP”) të emëruar nga Kryeministri për një mandat katër (4) vjeçar pa mundësi të vazhdimit, duke pasur parasysh diversitetin gjeografik në Kosovë, përveç të emëruarit të parë (1) nga një KSKK dhe një KLSP i cili do të shërbejë për një mandat dyvjeçar (2) pa mundësi të vazhdimit. Kryeministri do të sigurojë që së paku një anëtar të jetë femër, së paku një të jetë nga komuniteti serb i Kosovës dhe së paku një anëtar nga komunitetet joshqiptare dhe joserbe i Kosovës.

3.2 Mandati i anëtarit të Bordit pushon nëse ai nuk e mban postin në të cilin bazohet anëtarësimi i tij. Në rastet e neneve 3.1 (a)-(h), për çdo vend të lirë do të gjendet zëvendësimi. Në rastin e nenneneve 3.1 (i)-(k), çdo vend i lirë do të plotësohet me një të emëruar të përkohshëm, i cili do të shërbejë pjesën e mbetur të mandatit në fjalë. Kur periudha e emërimit të përkohshëm është më pak se gjysma e mandatit të plotë, anëtari i përkohshëm ka të drejtë të riemërohet.

3.3 Bordi mund të ftojë përfaqësues ndërkombëtar për të shërbyer si vëzhgues në Bord, të cilët do të kenë të drejtë të marrin pjesë dhe të diskutojnë në të gjitha takimet e Bordit dhe të marrin njoftime nga ai, si dhe të marrin dhe të komentojnë mbi gjithë dokumentacionin e ofruar Bordit.

3.4 Bordit do t’i ofrohen shërbime të Sekretariatit dhe shërbime të tjera mbështetëse nga Qendra kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim.

Neni 4

Financimi dhe mbështetja

4.1 Anëtarët e Bordit të emëruar në pajtim me nënnetet 3.1 (j) dhe 3.1 (k) do të marrin kompensim në formë të pagesës për vijueshmëri për çdo takim të Bordit ku ata kanë marrë pjesë, e cila pagesë mbetet të caktohet në pajtim me ligjin në fuqi.

4.2 Shpenzimet administrative dhe shpenzimet tjera do të mbulohen nga Qendra kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim.

Neni 5

Mbledhjet e Bordit

5.1 Bordi do të takohet aq herë sa e konsideron të nevojshme por jo më pak se çdo tre (3) muaj.

5.2 Bordi e zgjedh kryesuesin e vet me shumicën e votave. Kryesuesi do të shërbejë për një mandat njëvjeçar, i cili mandat do të ripërtëritet një herë pas mandatit të parë.

5.3 Bordi do të krijojë rregulloren e vet të punës, e cila do të bëhet publike. Në rregulloren e punës së Bordit do të parashihet se:

- a. për mbledhjet e Bordit do të nevojitet kuorum prej dhjetë (10) anëtarëve ;
- b. mbledhjet e Bordit do të mbahen me njoftim paraprak së paku prej pesë (5) ditëve të punës të gjithë anëtarëve të Bordit dhe vëzhguesve, në pajtim me nenin 3.3;
- c. vendimet e Bordit do të merren me shumicën e votave dhe do të regjistrohen sipas rregullit;
- d. mbledhjet e Bordit do të jenë të hapura për publikun;
- e. Bordi mund të themelojë nënkomisione sipas nevojës për të siguruar funksionimin e tij efikas dhe
- f. do të mbahen procesverbale për të gjitha mbledhjet dhe do të përfshihen edhe vendimet mbi kurset e certifikuara. Procesverbalet bëhen publike.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 26 mars 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm